R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2313/6 prot. Tiranë, më 22.9.2026

V E N D I M

Nr.39, datë 22.9.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Z. (në vijim "ankuesi") ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularin e ankesës nr. 2313 prot., datë 17.08.2026, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a." (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 29.07.2026, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Listën e plotë të të punësuarve në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a. për muajin korrik 2026, duke specifikuar: a) emrin dhe mbiemrin; b) pozicionin përkatës të punës; c) statusin e punësimit (me kontratë të përhershme, me kontratë me afat të caktuar ose formë tjetër punësimi, sipas rastit). Ky informacion të jetë i ndarë sipas secilës njësi shërbimi: Dibër, Bulqizë, Klos dhe Mat.*
2. *Kopje të vendimeve ose akteve për miratimin e strukturës organizative dhe organikës së Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a., si dhe dokumentacionin për kategoritë e pagave për çdo pozicion pune apo çdo ndryshim të bërë në strukturë gjatë vitit 2026.*
3. *Sa pozicione të lira pune ka aktualisht në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a.? Ju lutem specifikoni profesionet ose pozicionet përkatëse që janë vakante.*
4. *Sa është numri total i punonjësve të larguar nga detyra në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a. gjatë periudhës janar 2026 – korrik 2026? Ju lutem*

paraqisni një tabelë përmbledhëse, ku të specifikohet: a) numri i të larguarve sipas drejtorive, sektorëve ose njësive të shërbimit; b) arsyet e largimit (p.sh. dorëheqje vullnetare, zgjidhje e marrëdhënies së punës nga punëdhënësi, përfundim kontrate, ristrukturim, arritje e moshës së pensionit ose arsye të tjera të parashikuara nga legjislacioni).

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1216 prot., datë 19.08.2026, i ka kthyer përgjigje ankuesit në lidhje me kërkesën për informacion, duke sqaruar se: *"...Bashkëlidhur ju vihen në dispozicion aktet administrative për miratimin e strukturës organizative të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a., si dhe dokumentacioni që disponohet nga institucioni lidhur me kategoritë e pagave dhe ndryshimet e miratuara në strukturë gjatë vitit 2026. Gjithashtu, ju informojmë se në datën e trajtimit të kërkesës suaj, shoqëria nuk ka vende të lira pune. Lidhur me lëvizjet e personelit gjatë periudhës janar 2026 – korrik 2026, ju bëjmë me dije se nga shoqëria janë larguar gjithsej 17 punonjës. Largimet janë kryer për arsye të ndryshme, si dorëheqje vullnetare dhe dalje në pension pleqërie të parashikuara nga legjislacioni në fuqi".* Në këtë përgjigje nuk është trajtuar pika 1 e kërkesës, që lidhet me listën emërore të punonjësve, pozicionin dhe statusin e tyre të punësimit.

Në vijim të përgjigjes, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar në pikën 1 të kërkesës për informacion datë 29.07.2026.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI").

Në vijim të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, bazuar në pikën 3 të nenit 24 të LDI-së, si dhe në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, me shkresën nr. 2313/2 prot., datë 28.08.2026, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin dhe mosdhëniene dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 02.09.2026.

Me *email*-in e regjistruar me nr. 2313/3 prot., datë 01.09.2026, ankuesi ka vënë në dispozicion të Zyrës së Komisionerit përgjigjen e ardhur nga Autoriteti Publik me shkresën nr. 1240/1 prot., datë 28.08.2026, duke sqaruar se i qëndron vijimit të ankimit, pasi informacioni lidhur me listën emërore të të punësuarve sipas secilës njësi shërbimi, konkretisht Dibër, Bulqizë, Klos dhe Mat, nuk i është vënë ende në dispozicion.

Gjithashtu, me shkresën nr. 1268/1 prot., datë 02.09.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2313/5 prot., datë 08.09.2026, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje,

duke sqaruar, ndër të tjera, se: *"Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a. ka marrë në konsideratë pretendimet e ankuesit dhe dispozitat e LDI-së, dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Lidhur me pikën 1 të kërkesës për informacion, të dhënat që lidhen me emrin dhe mbiemrin e punonjësve, të kombinuara me statusin konkret të marrëdhënies së punës, mundësojnë identifikimin individual të personave dhe lidhen drejtpërdrejtë me marrëdhënien e tyre të punësimit. Për këtë arsye, kjo pjesë e informacionit është vlerësuar në përputhje me kufizimin e parashikuar në nenin 17 të LDI-së, i cili parashikon se e drejta e informimit mund të kufizohet kur kufizimi është i domosdoshëm dhe proporcional dhe dhënia e informacionit cenon, ndër të tjera, të drejtën për një jetë private. Gjithashtu, në zbatim të këtij neni, është mbajtur në konsideratë edhe parimi i interesit publik më të lartë për dhënien e informacionit. Në vlerësimin e Shoqërisë, kufizimi i kësaj pjese të informacionit është i nevojshëm dhe proporcional me qëllimin e mbrojtjes së të dhënave personale të punonjësve, duke pasur parasysh se kërkesa synon vënien në dispozicion të një liste të plotë emërore, ku çdo punonjës identifikohet individualisht dhe lidhet me statusin e tij konkret të punësimit. Nga ana tjetër, Shoqëria bën dallimin ndërmjet të dhënave identifikuese të punonjësve dhe informacionit me karakter organizativ dhe institucional. Për këtë arsye, informacioni që lidhet me strukturën organizative, pozicionet e punës, kategoritë përkatëse, si dhe informacioni i përgjithshëm mbi lëvizjet e personelit dhe shkaqet e largimeve, për aq sa përbën informacion publik dhe administrohet nga Shoqëria, i është vënë në dispozicion kërkuesit nëpërmjet përgjigjes nr. 1216 prot., datë 19.08.2026. Në këtë kuadër, Shoqëria vlerëson se kërkuesit i është vënë në dispozicion pjesa e informacionit me karakter publik që mund të jepet pa cenuar të drejtat e personave të tjerë, ndërsa pjesa që mundëson identifikimin individual të punonjësve dhe pasqyrimin e statusit të tyre konkret të punësimit është trajtuar në përputhje me kufizimet e parashikuara në nenin 17 të ligjit nr.119/2014, të ndryshuar. Për sa më sipër, Shoqëria mban qëndrimin se lista e plotë emërore e punonjësve, në formën e kërkuar, nuk mund të vihet në dispozicion në mënyrë të pakufizuar, për shkak të të dhënave personale që përmban dhe në zbatim të kufizimeve ligjore të sipërcituara. Shoqëria mbetet e gatshme të vendosë në dispozicion çdo informacion tjetër me karakter publik që administrohet prej saj, në përputhje me ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale".*

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka vijuar ankimin me *email*-in e datës 08.09.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2313/4 prot., datë 08.09.2026, duke pretenduar se: *"Argumentimi i paraqitur nga Shoqëria nuk është i mjaftueshëm as mbi baza ligjore për të justifikuar mosdhënien e informacionit të kërkuar në kërkesën time. UKD nuk identifikon konkretisht se cilat të dhëna të kërkuara do të cenonin të drejtën për privatësi dhe as nuk paraqet një vlerësim të individualizuar mbi nevojën dhe proporcionalitetin e kufizimit. Në mënyrë të përgjithshme, Shoqëria e konsideron të gjithë listën emërore si informacion që nuk mund të bëhet publik, pa argumentuar pse publikimi i emrit, mbiemrit, pozicionit të punës dhe njësisë ku ushtron detyrën, në rastin e një shoqërie që ofron shërbim publik dhe administron burime publike, do të sillte domosdoshmërisht cenim të të drejtave të punonjësve. Gjithashtu, kërkesa ime nuk ka të bëjë me të dhëna private të karakterit personal, si adresa, numra telefoni, të dhëna*

familjare apo të dhëna të tjera që lidhen me jetën private të punonjësve, por me identifikimin e personave që ushtrojnë funksione dhe pozicione pune pranë një shoqërie me funksion publik. Për këtë arsye, konsideroj se ekziston një interes publik i drejtpërdrejtë për transparencën mbi strukturën reale të personelit dhe mënyrën se si janë plotësuar pozicionet e punës. Nëse një pjesë e informacionit do të konsiderohej e mbrojtur, kjo nuk do të thotë automatikisht se duhet të refuzohet e gjithë kërkesa, por kërkon vlerësimin nëse informacioni mund të jepet pjesërisht, duke kufizuar ose anonimizuar vetëm të dhënat që realisht mbrohen nga ligji. Për sa më sipër, ju informoj se ankesa ime vijon për këtë pjesë të kërkesës, pasi informacioni i kërkuar nuk është vënë në dispozicion dhe autoriteti publik ka konfirmuar tashmë në mënyrë të shprehur qëndrimin e tij për mosdhënien e listës së plotë".

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI-së.

Lidhur me statusin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a., nga aktet e administruara gjatë shqyrtimit rezulton se ajo është një shoqëri tregtare nën kontroll publik, e cila ofron shërbimin publik të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve.

Në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: *""Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj"*. Për rrjedhojë, shoqëria përfshihet në nocionin "autoritet publik", sipas nenit 2, pika 1, të LDI-së, dhe i nënshtrohet detyrimeve që burojnë nga ky ligj.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI në nenin 1 përcakton se: *"1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike".*

Në interpretim të kombinuar të këtyre dispozitave, rezulton se qëllimi i ligjvënësit është garantimi i njohjes së publikut me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe kontrollit publik mbi veprimtarinë e tyre. Për këtë qëllim, autoritetet publike kanë detyrimin të trajtojnë në mënyrë efektive kërkesat për informacion dhe t'i mundësojnë kërkuesit akses në informacionin publik, përveç rasteve kur ekziston një kufizim i parashikuar shprehimisht nga ligji dhe janë përmbushur kushtet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit për zbatimin e tij.

Lidhur me qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik se, *vënia në dispozicion e listës së plotë emërore të punonjësve, e kombinuar me statusin konkret të marrëdhënies së punësimit, do të cenonte të drejtën për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale*, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar refuzimin e plotë të kërkesës. Informacioni i kërkuar lidhet me strukturën e personelit të një shoqërie që ushtron funksion publik, me pozicionet e punës dhe me personat që i ushtrojnë ato. Për rrjedhojë, ky informacion lidhet drejtpërdrejt me organizimin, funksionimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit Publik. Fakti që informacioni përmban të dhëna të cilat lidhen me persona të identifikueshëm, nuk e përjashton automatikisht atë nga fusha e së drejtës për informim.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson të nevojshme të sqarojë se referimi i përgjithshëm i Autoritetit Publik në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar refuzimin e dhënies së informacionit. Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për informim duhet të zbatohen në mënyrë të harmonizuar, duke vlerësuar, për çdo rast konkret, nëse dhënia e informacionit sjell cenim të një interesi të mbrojtur dhe, nëse po, në çfarë mase ky kufizim është i domosdoshëm dhe proporcional. Në rastin konkret, kërkesa nuk synon marrjen e informacionit që lidhet me sferën ngushtësisht private të punonjësve, si adresa e banimit, numri personal i telefonit, të dhënat familjare, të dhënat shëndetësore apo të dhëna të tjera të kësaj natyre. Objekti i saj lidhet me identitetin profesional të personave të punësuar, pozicionin që mbajnë, si dhe njësinë e shërbimit ku ushtrojnë detyrën në kuadër të ushtrimit të funksionit dhe marrëdhënies së punës pranë një subjekti që ushtron funksion publik.

Në këto kushte, duke qenë se në kërkesë bëhet fjalë për funksionar publik, ekziston një përjashtim referuar pikës 2 të nenit 44 të Ligjit 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ku parashikohet se: *"Aksesi i publikut në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, dhe aksesi i publikut në informacionin që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar rastesh".*

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se dhënia e informacionit që përmban të dhëna personale duhet të shqyrtohet në mënyrë të harmonizuar me detyrimin ligjor të Autoritetit Publik për garantimin e së drejtës për informim. Fakti që informacioni mundëson identifikimin e një personi, nuk përbën në vetvete shkak të mjaftueshëm për refuzimin e tij, pasi informacioni i kërkuar lidhet drejtpërdrejt me strukturën e personelit, pozicionet e punës, shpërndarjen e punonjësve sipas njësive të shërbimit dhe statusin e marrëdhënies së tyre të punësimit pranë një subjekti që ushtron funksion publik. Duke marrë në konsideratë natyrën profesionale të të dhënave, përdorimin e burimeve publike dhe interesin për transparencë mbi organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Publik, rrjedhimisht dhënia e informacionit të kërkuar është e domosdoshme dhe proporcionale.

Nisur nga rrethanat konkrete të çështjes, interesi publik për dhënien e informacionit prevalon ndaj interesit për kufizimin e tij për shkak të mbrojtjes së jetës private.

Gjithashtu, Komisioneri çmon se ekziston interes publik për transparencën lidhur me strukturën reale të personelit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a., pozicionet e punës që ushtrohen në kuadër të saj dhe shpërndarjen e punonjësve sipas njësive të shërbimit Dibër, Bulqizë, Klos dhe Mat. Ky interes lidhet me nevojën për transparencë mbi organizimin, funksionimin dhe përdorimin e burimeve njerëzore nga një subjekt që ushtron funksion publik.

Në këtë drejtim, neni 7 i LDI-së parashikon detyrimin e autoriteteve publike për të bërë publik, në përputhje me programin e transparencës, informacionin që lidhet me organizimin, funksionimin, strukturën dhe veprimtarinë e tyre. Në veçanti, shkronja "d" e pikës 1 të nenit 7 të LDI-së dhe Urdhri nr. 280 datë 18.12.2025 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për autoritetet publike", i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, parashikojnë publikimin proaktiv të disa kategorive të informacionit që lidhen me funksionarët dhe strukturën e pagave.

Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se: *"Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet ... d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime".*

Nga sa më sipër, Autoriteti Publik jo vetëm duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, por në zbatim të nenit 7 të LDI-së duhet që informacionin e kërkuar ta bëjë publik në mënyrë proaktive në Programin Institucional të Transparencës.

Në këtë kontekst, sjellim në vëmendjen tuaj se Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare, konkretisht në linkun *https://idp.al/vendime-informimi/*, si: vendimet nr.32, datë 10.07.2018; nr. 21, datë 09.04.2021; nr. 23, datë 13.04.2021; nr. 50, datë 17.11.2021; nr. 19, datë 15.05.2023 etj. Kjo praktikë duhet marrë në konsideratë për aq sa rrethanat faktike dhe juridike të rasteve janë të krahasueshme me çështjen objekt shqyrtimi dhe duke mbajtur parasysh ndryshimet në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, si dhe nxitjen e integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë së tyre. Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI-së, parashikohet se: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

E drejta për informim është një e drejtë themelore, e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe mundësinë e kontrollit publik mbi organizimin dhe veprimtarinë e autoriteteve publike.

Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe, kur informacioni përmban të dhëna personale, dhënia e tij duhet të vlerësohet në përputhje me kufizimet, kriteret e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit, si dhe parimin e aksesit të pjesshëm, të parashikuar nga neni 17 i LDI-së.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, si dhe shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankesës nr. 2313 prot., datë 17.08.2026, të z. , kundër Autoritetit Publik "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a.", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 29.07.2026, konkretisht: *Listën e plotë të të punësuarve në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër sh.a. për muajin korrik 2026, duke specifikuar për secilin punonjës: a) emrin dhe mbiemrin; b) pozicionin përkatës të punës; c) statusin e punësimit (me kontratë të përhershme, me kontratë me afat të caktuar ose formë tjetër punësimi, sipas rastit). Ky informacion të jetë i ndarë sipas secilës njësi shërbimi: Dibër, Bulqizë, Klos dhe Mat*, duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, brenda datës 30.9.2026.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallë së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

Ky vendim u shpall sot, më datë 22.9.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi